


# PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË MITROVICËS

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË MITROVICË ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





# PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

**ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.”** Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-rra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



# PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi iniciohet dhe derivohehet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





# OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN  
TË ARRIHEN:

1

Përfshirja e drejtpërdrejtë e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja e këtyre propozimeve ose jo nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Intensifikimi i komunikimit ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.





## Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:

**1** Përveç domosdoshmërisë për rritje të cilësisë në shkolla profesionale, autoritetet komunale do të mund të lehtësonin komunikimin e të diplomuarve me tregun e punës. Themelimi i një qendre për orientim në karrierë do të mund të ishte një opsion. Kjo qendër, më pas do të luante rolin e lehtësuesit dhe do ndërmjetësonte komunikimin në mes të bizneseve lokale dhe të diplomuarve. Është e domosdoshme që autoritetet të ndërmarrin masa me qëllim të rritjes së cilësisë në shkolla. Një mundësi do të mund të ishte ngritja e nivelit të inspektimit nga ana e përgjegjësve. Po ashtu, autoritetet lokale përmes qendrës për orientim në karrierë do të mund të mbante sesione informuese në shkolla fillore mbi mundësitë që ofrohen nga shkollat profesionale.

**2** Autoritetet komunale duhet me prioritet të trajtojnë problemin e sigurisë në shkolla. Përveç pranisë së policëve pranë objekteve (sidomos tek shkollat e mesme), një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë në mes të shkollës dhe prindërve mund të shihen si masa të nevojshme.

**3** Është esenciale që higjiena në tualetet e shkollave të përmirësohet. Ky problem mund të adresohet duke kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie nga menaxhmenti i shkollave. Një inspektim më i shpeshtë nga ana e inspektorëve gjegjës do të ndihmonte në këtë aspekt.

Gjithsesi, ngritja e vetëdijes së nxënësve rreth higjienës duhet të jetë angazhim i vazhdueshëm nga ana e mësimitdhënësve. Autoritetet lokale duhet të konsiderojnë si opsion mundësinë e furnizimit të shkollave me aparate për ujë të pijshëm. Duke qenë se është projekt që implikon kosto financiare, autoritetet do të duhej të kërkonin edhe mundësi tjera tek donatorët e mundshëm, së paku për blerjen e aparateve të ujit.

**4** Autoritetet lokale duhet të pajisin shkollat me kabinete gjegjëse si kusht për ngritje të cilësisë.

**5** Të funksionalizohet sa më parë hapësira e re për bibliotekën e qytetit si dhe të shikohen mundësitë për shtimin e fondit të literaturës që do të reflektonte edhe drejtimet e fakulteteve në Universitetin e qytetit.





## SEKTORI I RINISË



### Problemet e identifikuara:

Pjesëmarrja e të rinjve në procesin e bërjes së politikave është normuar me Ligjin për Fuqizimin e Rinisë, dhe Strategjinë për të rinjtë 2013-2017. Me të njëjtat akte legale janë përcaktuar roli dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale në krijimin e hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore. Në Strategjinë për të rinjtë janë definuar objektivat strategjike që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 Pjesëmarrja e të rinjve i Strategjisë së Kosovës për të rinjtë 2013-2017).

Grupi i të rinjve, mbështetur në këto objektiva, ka trajtuar sfidat që ballafaqojnë të rinjtë e komunës dhe ka identifikuar problemet në vijim që duhet të adresohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale: Qasja e limituar e autoriteteve lokale në përfshirje dhe mbështetje të numrit të caktuar të OJQ-ve që kanë implementuar aktivitete me të rinj në të kaluarën. Mungesë e madhe e aktiviteteve për të rinjtë në komunë. Mungesë absolute e përfshirjes së të rinjve nga fshatrat në ndonjë aktivitet. Mungesë e përgjithshme e aktiviteteve vullnetare dhe vullnetit të të rinjve për aktivitete të tilla.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet lokale të ndryshojnë qasjen ndaj organizatave dhe të mos mbështesin vetëm organizata të caktuara në aktivitetet e tyre për të rinjtë. Është e domosdoshme që të gjitha organizatat dhe iniciativat që vijnë nga grupe ose organizata të trajtohen njëjtë sepse një qasje e tillë rritë edhe konkurrencën por edhe cilësinë e aktiviteteve.

**2** Komuna e Mitrovicës ndër të parat në Kosovë ka aprovuar rregulloren për vullnetarizëm. Autoritetet komunale ta implementojnë atë Rregullore e cila parasheh edhe forma dhe mënyra të ndryshme për stimulim të të rinjve, përfshirë edhe njohjen e punës vullnetare si përvojë e punës. Stimulime shtesë që do të mund të ofroheshin nga autoritetet lokale për nxitjen e vullnetarizmit janë bileta me gjysmë çmimi ose falas për bibliotekën e qytetit, për teatër, palestrën e sporteve – komuna mund të mbuloj shpenzimet kur të rinjtë organizohen në ndonjë aktivitet sportiv në palestër etj.

**3** Të funksionalizohet dhe të rritet angazhimi i qendrës rinore. Qendra rinore mund të pajiset me kompetencë që të koordinoj dhe menaxhoj aktivitetet e të rinjve. Përmes qendrës rinore, të rinjtë vullnetarë mund të pajisen me kartela identifikuese si dhe të regjistrohen në një bazë të dhënash që do të përditësohej dhe menaxhohej nga qendra ose sektori i rinisë në administratën komunale.

**4** Vullnetarizmi si aktivitet të promovohet në baza të rregullta me qëllim të regjistrimit dhe përfshirjes së vazhdueshme të vullnetarëve të rinj. Përmes qendrës rinore, autoritetet mund të organizojnë një fushatë informuese për të rinjtë e shkollave të mesme – në fillim të vitit shkollor. Një aktivitet i tillë të organizohet në çdo fillim viti shkollor ashtu që të rinjtë që largohen për studime ose punë të zëvendësohen me të rinj të tjerë.

**5** Është e domosdoshme që autoritetet lokale të trajtojnë me prioritet problemin e mospërfshirjes së të rinjve nga fshatrat në aktivitete rinore. Një opsion për t'u konsideruar mund të jetë themelimi dhe mbështetja e klubeve ose qendrave rinore në nivel të bashkësive lokale!





# 3

## SEKTORI INFRASTRUKTURË/ TRANSPORT



### Problemet e identifikuara:

Grupi i të rinjve ka trajtuar edhe problemet që aktualisht hasen në fushën e transportit dhe atë të infrastrukturës në komunë. Përkundër diskutimit të shumë problemeve që hasen në këto dy fusha, dhe për qëllim të kësaj propozim-platforme, të rinjtë kanë identifikuar dy çështje që kërkojnë të adresohen me prioritet: Mungesa e transportit publik


të rregullt. Ndonëse është çështje e ndjeshme për shumë operatorë privat që aktualisht veprojnë si transport publik, gjendja e tanishme është e paqëndrueshme dhe duhet të adresohet me prioritet nga ana e autoriteteve lokale. Mungesa e funksionimit të semaforëve në dy lokacione ku janë të vendosura.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet komunale duhet të adresojnë problemin e transportit publik me qëllim të vënies së rregullit por edhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Grupi i të rinjve propozon vendosjen e linjave të rregullta të transportit publik në relacionet si në relacionet: Mitrovicë – Shalë e Bajgorës; Mitrovicë – Lushtë; Mitrovicë – Qabër; Mitrovicë – Gushavc/Vinarc; dhe Mitrovicë – Boletin, Zhazhe. Disa fshatra tjera do të mund të mbuloreshin nga operues privat.

**2** Autoritetet komunale të trajtojnë me prioritet edhe vënien në funksion të semaforëve tek stacioni i autobusëve si dhe tek Adriatiku. Në veçanti, pjesa tek Adriatiku duhet të jetë prioritet meqë frekuentimi i këmbësorëve (nxënësve) është shumë i lartë.





# 4

## SEKTORI I SHËNDETËSISË



### Problemet e identifikuara:

Gjendja aktuale në shërbimet shëndetësore që bien në kompetencë të autoriteteve lokale ka qenë një fushë tjetër e trajtuar nga ana e të rinjve. Hapja dhe funksionalizimi i qendrave të mjekësisë familjare në disa pjesë periferike dhe fshatra të komunës synojnë edhe ofrimin e shërbimeve gjegjëse për qytetarët. Si do qoftë, grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim që kërkojnë të adresohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale. Është evidente që problemet e identifikuara, kryesisht

nuk implikojnë shpenzime buxhetore dhe mund të zgjidhen vetëm me vullnet të mirë të autoriteteve gjegjëse: Mungesa e mjekëve gjatë gjithë orarit në qendrat e mjekësisë familjare detyron pacientët të kërkojnë zgjidhje në institucione tjera shëndetësore. Mungesa e higjienës në nivelin e duhur në objekte shëndetësore. Mungesa e shpeshtë e barnave/ materialeve esenciale – detyron qytetarët të gjejnë zgjidhjen vetë. Mungesa e kutive për ankesa në qendra ku qytetarët mund të vendosin ankesat eventuale.




# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet komunale të kërkojnë zbatimin e orarit dhe ta monitorojnë procesin në secilën qendër të mjekësisë familjare dhe institucione tjera shëndetësore që i kanë në kompetencë. Inspektimi më i shpeshtë nga inspektorët gjegjës dhe kërkimi i përgjegjësishë nga menaxhmenti mund të jenë opsione për adresim të këtij problemi.

**2** Autoritetet lokale të trajtojnë me prioritet edhe problemin e pastërtisë dhe higjienë në të gjitha objektet shëndetësore. Ngritja e nivelit të përgjegjësishë dhe llogaridhënies si dhe angazhimi më azhur nga ana e inspektorëve gjegjës mund të jenë zgjidhje për këtë problem. Mbase, aplikimi i masave ndëshkuese, sikur parashihen me ligjet e aplikueshme mund të rezultojnë pozitivisht në vendosjen e disiplinës tek stafi në qendrat e mjekësisë familjare.

**3** Problemi i mungesave të barnave esenciale por edhe materialeve tjera është shndërruar në dukuri të shpeshtë nëpër qendrat e mjekësisë familjare. Me qëllim të përjashtimit të mundësisë për keqpërdorim, autoritetet lokale mund të aplikojnë një bazë të dhënash me barna esenciale që përditësohet dhe menaxhohet nga ana e drejtorisë gjegjëse komunale. Po ashtu, autoritetet duhet vazhdimisht të koordinohen me nivelin qendror me qëllim të sigurimit të barnave esenciale.

**4** Të vendosen kutitë e ankesave për qytetarë në qendra të mjekësisë familjare, kudo që mungojnë, dhe ankesat e qytetarëve të trajtohen një herë në muaj nga një panel ku do të përfshiheshin edhe anëtarë nga komuniteti dhe shoqëria civile së bashku me përfaqësuesit e institucioneve. Një veprim i tillë do të rriste nivelin e përgjegjësishë tek stafi i qendrave.





## SEKTORI SOCIAL



### Problemet e identifikuara:

Për qëllim të kësaj propozim-platforme, grupi i të rinjve ka zgjedhur të trajtoj dhe identifikoj problemet që ballafaqojnë kategoritë e qytetarëve me aftësi të kufizuara, përkundër problemeve të shumta sociale të shumë qytetarëve. Është e domosdoshme që autoritetet lokale, por jo vetëm ato, të adresojnë me prioritet disa nga problemet kryesore që

ballafaqojnë këto kategori. Të rinjtë kanë identifikuar problemet në vijim: Mungesa e konsiderueshme e infrastrukturës për qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuar në objektet publike. Mungesa e hapësirës së nevojshme për aktivitete për këto kategori. Mungesa e mbështetjes financiare.







# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet lokale të kenë në fokus të vazhdueshëm nevojën për mbështetje për këto kategori të qytetarëve. Të identifikohen të gjitha objektet publike në të cilat mungojnë pjerrinat e domosdoshme për qarkullim të karrigeve lëvizëse dhe të njëjtat të njëjtë të vendosen me prioritet. Të trajtohet me prioritet vendosja e shiritit të gjelbër në sheshet kryesore në qytet dhe varësisht nga mundësitë të vazhdohet edhe në pjesët tjera.

**2** Autoritetet komunale me prioritet të mbështesin nxënësit nga këto kategori nga sigurimi i transportit deri tek mbështetja financiare për nevojat që kanë për pajisje shkollore.

**3** Të identifikohet dhe përcaktohet një hapësirë që do plotësoj kushtet elementare për organizimin e aktiviteteve dhe takimeve të këtyre kategorive. Autoritetet lokale të shohin mundësinë për mbështetje financiare të organizatës Handikos që merret me këto kategori të qytetarëve.





## Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

ALBANA UKA

ELVIS FEKA

JETA MUSTAFA

ALBULENA UKA

ERIONA PEÇI

LAURA TAHIRI

ARRITA DEVA

FAIK MZIU

MIRJONDA MUSTAFA

BONITA IMERI

FITORE BEHRAMI

MIRLINDA AZEMI

DEA MUSTAFA

FITORE SYLA

NITA SARAÇI

DIELLZA UKA

FLORIM AHMETI


REFIK TUPELLA

DORENTINA KAMERAJ

GENTIANA HAZIRI

SARA FAZLIU





**Duke pasur parasysh kufizimet  
buxhetore si dhe problemet që  
ballafaqojnë komunat në procesin  
e hartimit të buxheteve komunale,  
diskutimi dhe puna e grupeve të të  
rinjve është orientuar në identifikimin  
e çështjeve që janë të prekshme,  
të zbatueshme dhe që në pjesën  
më të madhe nuk kanë implikime  
të mëdha buxhetore.**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina